



Në bazë të Programit të aktiviteteve nga fusha e zhvillimit lokal ekonomik të Qytetit të Shkupit për vitin 2024 ("Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 12/24) dhe në lidhje me Nenin 4 të Rregullores për mënyrën, kushtet dhe procedurën e dhënies së mjeteve financiare për realizimin e evenimenteve, forumeve, festivaleve, manifestimeve, projekteve dhe aktiviteteve projektuese në fushën e zhvillimit lokal ekonomik nr. 08-10467/1, datë 25.09. 2024, Qyteti i Shkupit shpall:

**Thirrje publike
për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e festivalit
"Festivali Shkupi Tajmles (Skopje timeless)"**

1. LËNDA

1.1. Lëndë e Thirrjes publike është realizimi i festivalit:
"Festivali Shkupi Tajmles (Skopje timeless)"

2. E DREJTA PËR PJESËMARRJE

2.1. Të drejtë për të marrë pjesë në Thirrjen publike kanë të gjitha shoqatat e qytetarëve, fondacionet, federatat, institucionet, shoqëritë tregtare dhe agjencitë e marketingut, të regjistruara në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut me seli në Shkup, në pajtim me Ligjin për Shoqatat dhe Fondacionet dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare të cilat plotësojnë kushtet dhe kriteret e përgjithshme dhe kanë depozituar dokumentacionin e nevojshëm.

2.2. Nëpërmjet Thirrjes publike do të ndahen mjete për financimin e festivalit nga pika 1, nënpika 1.1, si dhe për zhvillimin, promovimin, mbështetjen dhe avancimin e hotelerisë dhe turizmit dhe aktivitete të tjera me rëndësi të veçantë për qytetin e Shkupit.

3. KORNIZA KOHORE DHE MËNYRA E NDARJES SË MJETEVE

3.1. Mjetet janë siguruar nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2024 në Programin e aktiviteteve në fushën e zhvillimit lokal ekonomik të Qytetit të Shkupit për vitin 2024 ("Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit" numër 12/24). Shfrytëzimi i mjeteve të ndara do të rregullohet me lidhjen e Kontratës ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe aplikantit i cili i plotëson kriteret në përputhje me Thirrjen Publike.

4. KRITERE THEMELORE

4.1. Kriteret themelore organizative që duhet të plotësojnë aplikantët e interesuar që marrin pjesë në këtë thirrje janë:

- Të jenë regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut me seli në Shkup;
- të kenë shlyer obligimet ndaj Qytetit të Shkupit (tatime, taksa komunale) dhe

- të mos kenë ndalim për pjesëmarrje në procedurat e thirrjeve publike, dhënies së kontratave të prokurimit publik dhe kontratave për partneritet publik privat.

5. KRITERE TË VEÇANTA DHE MËNYRA E PIKËZIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E APLIKANTËVE

5.1. Kriteret e veçanta për përzgjedhjen e aplikantëve parashikohen në Rregulloren për mënyrën, kushtet dhe procedurën e ndarjes së mjeteve financiare për realizimin e manifestimeve, forumeve, festivaleve, manifestimeve, projekteve dhe aktiviteteve projektuese në fushën e zhvillimit lokal ekonomik, e cila është publikuar në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit.

5.2. Vlerësimi i cilësisë së projekteve të aplikantëve të interesuar që plotësojnë kriteret themelore organizative do të kryhet në bazë të kriterëve të përcaktuara në pikën 5 të Thirrjes publike. Pikëzimi i projektit më të mirë të propozuar do të bëhet nga Komisioni i formuar nga kryetarja e Qytetit të Shkupit.

6. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM TË CILIN DUHET TA DEPOZITOJË APLIKANTI TË BASHKËNGJITUR ME APLIKIMIN

6.1. Për ndarjen e mjeteve për financimin e festivalit “Festivali Shkupi Tajmles (Skopje timeless)”, aplikanti duhet të depozitojë bashkëngjitjet e mëposhtme:

- Aplikacioni i plotësuar me shkronja cirilike, i nënshkruar nga personi kompetent dhe i vërtetuar me vulën e aplikantit (aplikimi do të publikohet në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk)
- Gjendja aktuale nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut ose Aktvendimi për regjistrimin e personit juridik;
- Deklaratë e nënshkruar për shlyerjen e detyrimeve ndaj Qytetit të Shkupit (tatime, taksa komunale);
- Vërtetim se nuk ka ndalim për pjesëmarrje në procedurat e thirrjeve publike, dhënien e kontratave të prokurimit publik dhe kontratave për partneritet publik privat (Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut);
- Projekt propozim i përgatitur me shkronja shtypi në alfabetin cirilik;
- Plan financiar i plotësuar me shkronja shtypi në alfabetin cirilik.

7. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

7.1. Aplikantët të bashkëngjitur duhet të depozitojnë edhe dokumentacionin shoqërues të mëposhtëm:

- Biografi profesionale e ekspertëve që do të angazhohen në realizimin e festivalit,
- lista e referencës,
- të paktën dy mendime/referenca nga partnerë apo donatorë për realizimin e festivaleve të mëparshme,
- mbështetje me shkrim nga organizata apo institucione të tjera që planifikohen të marrin pjesë në realizimin e festivalit dhe
- plani i marketingut i festivalit.

8. MËNYRA E REALIZIMIT TË THIRRJES PUBLIKE

8.1. Për të konstatuar plotësimin e kushteve dhe kriterëve të përgjithshme për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e festivalit “Festivali Shkupi Tajmles (Skopje timeless)”, kryetarja e Qytetit të Shkupit formon Komisionin për zbatimin e thirrjes publike për ndarjen e mjeteve për financimin e festivaleve, evenimenteve dhe manifestimeve në fushën e turizmit dhe hotelerisë (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni).

8.2. Aplikimet që nuk janë depozituar në afatin e përcaktuar, të parregullta (të palexueshme) ose të paplota dhe që nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret do të refuzohen nga Komisioni me Konkluzion dhe nuk do të shqyrtohen, gjë për të cilën do të njoftojë aplikantët, aplikimet e të cilëve janë refuzuar.

8.3. Për aplikimet që janë të plota, të depozituara në kohë dhe plotësojnë kushtet dhe kriteret, Komisioni depoziton propozim pranë kryetares së Qytetit të Shkupit për përzgjedhjen e aplikantit për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e festivalit.

8.4. Kryetarja e Qytetit të Shkupit, me propozim të Komisionit, miraton Aktvendim për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e festivalit “Festivali Shkupi Tajmles (Skopje timeless)”.

Vërejtje:

- ***Aplikimet me dokumentacion të paplotë ose të depozituara pas përfundimit të afatit të parashikuar nuk do të shqyrtohen! Bashkëngjitjet e depozituara nuk kthehen.***
- ***Çdo aplikant mund të depozitojë vetëm një aplikim për Thirrjen publike.***

9. AFATI DHE MËNYRA E DEPOZITIMIT TË APLIKIMEVE

9.1. Afati për depozitimin e aplikimeve është 5 (pesë) ditë nga dita e shpalljes së Thirrjes publike.

9.2. Aplikimi me dokumentacionin e plotë duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur në adresën: **Qyteti i Shkupit, Sektori për Zhvillim Lokal Ekonomik, bul. “Ilinden“ nr.82, 1000 Shkup** (me shënimin - Sektori për Zhvillim Lokal Ekonomik – Aplikim për Thirrje publike).

9.3. Aplikantët e Thirrjes publike do të njoftohen për rezultatet brenda 15 ditëve nga dita e përfundimit të Thirrjes publike.

9.4. . Dokumentacioni i plotë, aplikimet për mbështetje financiare, përmbajtja, kushtet dhe kriteret themelore/të veçanta (bashkëngjitje të aplikimit) dhe plani financiar për projektin janë në dispozicion në ambientet e Qytetit të Shkupit, Sektori për Zhvillim Lokal Ekonomik, baraka nr.6, zyra nr.3: www.skopje.gov.mk.

9.5. Pyetjet sqaruese mund të depozitohen me shkrim ose në mënyrë elektronike pranë Sektorit për Zhvillim Lokal Ekonomik.

Tel. kontaktues: (02)3297-284 dhe e-mail adresa:

Biljana.Stojmanovska@skopje.gov.mk

QYTETI I SHKUPIT